



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 326/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi, anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Naim Fetahu, shef i shtabit zgjedhor i subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Besianë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) për shkak të heqjes dhe dëmtimit të posterave , në seancën e panelit të mbajtur me 08.12.2010, mori këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa si e pabazuar.

ARSYETIM

Naim Fetahu, shef i shtabit zgjedhor (SHZ) i subjektit politik PDK dega në Besianë, ka parashtruar Ankesë kundër subjektit politik LDK, e cila sipas tij ka bërë shkeljen e Rregullës Zgjedhore “Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët” NR.11/2009 neni 3.1 pika (a), duke bërë Veprime të Ndaluara, më datë 03.12.2010 rreth mesnatës në Besianë kanë shqyer posterat e kandidatëve të PDK-së dhe është bërë zëvendësimi me posterat e kandidatëve të LDK-së.

Më 06 dhjetor 2010, (PZAP) ka pranuar një ankesë që i ishte dorëzuar nga Naim Fetahu, SHZ i subjektit politik PDK dega në Besianë.

Parashtruesi i ankesës si shkelës të supozuar ka paraqitur Naser Ramën administrator të subjektit politik LDK dega në Besianë dhe si provë ka bashkangjitur disa foto si dëshmi nga vendi i ngjarjes.

PZAP-i e informoi subjektin politik LDK, më datë 06.12.2010, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 07.12.2010, gjerë në ora 12:00.

PZAP-i, pranoi përgjigjeje në ankesë nga subjekti politik LDK, në të cilën theksohet se; ankesa e PDK-së është e pabazuar në fakte pasi që të gjitha fotot e bashkangjitura të kësaj ankese nuk dëshmojnë atë që thuhet në ankesë dhe se posterat e dëmtuar të

PDK-së me asgjë nuk mund të dëshmohet se janë dëmtuar nga ana e simpatizuesit të LDK-së.

Po ashtu PZAP-i i ka bërë një kërkesë urgjente PK-së përkatësisht Kapitenit Policor Baki Kelani lidhur me rastin, i cili kishte informuar se me datë 04.12.2010 SHPK ka pranuar një ankesë nga SHZ i PDK-së, Naim Fetahu se me datë 03.12.2010 pas orës 23:00 subjekti politik LDK dega në Podujevë, sipas tyre kishte shqyer posterat e kandidatëve të PDK-së dhe të njëjtit i kishin zëvendësuar me posterat e kandidatit të tyre.

PK pas konsultimit me Prokurorin Komunal Ilaz Beqiri, ka njoftuar se nuk është hapur asnjë rast dhe se kjo konsiderohet si shkelje administrative dhe e dënueshme me gjobë sikurse është përcaktuar nga PZAP-i

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) parashohin si vijon:

- c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

Prandaj duke e shqyrtuar dhe analizuar ankesën e PDK-së se ankesa në fjalë ka mungesë të provave për t'u bindur se Naser Rama administrator i subjektit politik LDK-së ka dëmtuar posterat e kandidatëve të PDK-së, dhe se fotot e ofruara si prova nuk japin ndonjë dëshmi bindëse për shkeljen e pretenduar, pasi që heqja dhe dëmtimi i posterave ka mundur të bëhet nga çdokush.

PDK nuk ka dorëzuar fakte të qarta dhe të argumentuara të cilat argumentojnë ankesën.

PZAP-i konsideron që PDK nuk ka vepruar në pajtim me nenin 3.6 pika (c) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 326/2010 më datën 08.12.2010.

